



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:917948

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05721843

Ac.nr.7083/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi – Saraçi, në çështjen juridike të paditësit Sh. G nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson, N. B avokat, kundër të paditurit A. G nga Vushtrria, të cilin me autorizim e përfaqëson A. A, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.20/21 të datës 16.07.2021, me datë 21.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurit A. G nga Vushtrria, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.20/21 i datës 16.07.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit obligohet i padituri A. G që në emër të borxhit nga raportet e ndërgjyqësve lidhur me shitblerjen e vajit motorik dhe pagesat e bëra nga paditësi lidhur me këtë mall ne shërbimet doganore, t'ia paguaj paditësit Sh. G, shumen prej 11.481 € dhe atë për shitjen e vajit motorik shumen prej 4.481 €, ndërsa për pagesën e doganimit të këtij malli shumen prej 7.000 €, me kamate sipas lartësisë së mjeteve që paguhen për një vit ne banka pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë me date 28.02.2005, e gjere ne pagesën definitive të borxhit. Në pikën II., të dispozitivit obligohet i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale paditësit t'ia paguaj shumen totale prej 1,122 €, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën paralajmërimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i padituri për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit këtë ankesë ta aprovoj si të bazuar duke e prishur aktgjykimin e atakuar dhe të hedhet padia e paditësit si e pa bazuar.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi S. G ka parashtruar padi ndaj të paditurit A. G, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri A. G që në emër të borxhit nga raportet e ndërgjyqësve lidhur me shitblerjen e vajit motorik dhe pagesat e bëra nga paditësi lidhur me këtë mall ne shërbimet doganore, t'ia paguaj paditësit Sh. G, shumen prej 11.481 € dhe atë për shitjen e vajit motorik shumen prej 4.481 €, ndërsa për pagesën e doganimit te këtij malli shumen prej 7.000 €, me kamate sipas lartësisë se mjeteve qe paguhen për një vit ne banka pa destinim te caktuar.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike: se palët ndërgjyqëse mes tyre kanë qenë në raporte ortakërie dhe në këtë raport te dy palët kane investuar bashkërisht. Palët ndërgjyqëse janë ne afërsi familjare-kushërinj dhe se nuk është kontestues se vaji motorik i transportuar nga Greqia përmes Shqipërisë është magazinuar ne shtëpinë e te paditurit dhe çelësat e ka poseduar paditësi.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) të refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe të vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Nga gjendja e vërtetuar faktike, kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të të paditurit janë të pa themelta dhe vlerëson se, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykimin i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare. Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për atë se çfarë ka vendosur dhe këtë e ka bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruara nga ana e të paditurit, pasi që gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim të drejtë duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit. Kolegji gjen se, shuma e tërësishme që i padituri është i detyruar që t'ia kthej paditësit nga shitja e vajti motorik prej 11.000 litra ka qene rreth 19.000 €, ku 14.000 € i janë kthyer paditësit dhe ka mbetur shuma prej 4.481 €, ndërsa për pagesën e doganimit shumë prej 7000,00 €. Lidhur me pretendimet ankimore se kjo lëndë sipas vendimit të Gjykatës së Apelit ka qenë dashur që t'i ndahet një gjyqtari tjetër, kolegji gjen se, kjo gjë nuk është e përfshirë në dispozitivin e Aktvendimit Ac.5563/2017 të datës 07.12.2020. Nga të lartcekurat kolegji ka refuzuar ankesën e të paditurit duke aprovuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në nenin 319.1 të LPK-së: "Secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta". Kolegji gjen se pala e paditur nuk ka arritur që të argumentojë thëniet e tij, prandaj edhe sipas vlerësimit të kolegjit të njëjtat kanë ngelur vetëm në nivelin e pretendimeve dhe janë refuzuar si të pa bazuara.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura, e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7083/21, me datë 21.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj